

Data: 23.07.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE PËR PAJISJE TË NDRYSHME PËR
INSTITUCIONET NË VARËSI TË SHSSH”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)

Televizor me ngjyra 32324100-1

Frigoriferë 39711130-9

Lavatriçe dhe tharëse rrobash 39713200-5

Bolier ngrohës 42515000-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,621,367 (tre milionë e gjashtëqind e njëzet e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbështetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpermjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar ne nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se c)

40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.”

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

Në nenin 40 pika 3 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit.

Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë të Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshme dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët / fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjithë artikujt objekt prokurimi. Këto dokumente duhet të përmbajnë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet për transportin e mallrave	1 (një)	Pronësi / Me qera / Huapërdorje

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe çertifikata e pronësisë së mjetit/ (per mjetet qe kane lejen e qarkullimit te vjeter)

b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe çertifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë, ose të huapërdorjes (sipas rastit).

Shenim: Kriteri nr.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik që kualifikohet i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se kanë mjete në dispozicion dhe se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi, në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Ky kriter është vendosur si siguri, që operatori ekonomik do të kryejë shërbimin e transportit në kohë me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për minimumi 1 mjet është vendosur duke patur në konsideratë vendin e dorëzimit të mallit object prokurimi, pranë Autoritetit Kontraktor Komanda Mbështetëse, me adresë: Rr. “Faik Kulla” dhe afatin e lëvrimit të mallit që është 2 (dy) muaj pas nënshkrimit të kontratës.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- a) ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);
- b) ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Argumentimi: Kjo lërkesë është në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” ku përcaktohet

se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

5. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën e garancisë së mallrave objekt prokurimi nga data e dorëzimit të mallit, sipas afatit të përcaktuar në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli i lëvruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimi ose riparimi i tyre pa pagesë nga operatori ekonomik.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambientet e Autoritetit Kontraktor përfutjes.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Nr .	Emertimi	Njesia	Specifikmet teknike
1	Frigoriferë të vegjël	Cope	Tipi I Frigoriferit :Minibar, Lloji I ftohjes : me akull,Klasi I energjise: min A+ ,Kapaciteti Neto(Ngriresi/Freskuese): min 80 litra, Permasat (Gjxlxt)(cm): min 48x45x85,Materiali i rafteve :plastik ,Garancia : min 24 muaj
2	Televizor 43``	Cope	Permasat 43``,Paneli Led,Frekuenca HZ50,Smart Tv po,Sistemi Operativ Tizen,Wirless Po,Blootooth Po,Marresi DVB-C/T2/S2,Moduli CI+(1.4),Konsumi Standby(Watt)0 .5,Stema ekologjike G,Permasat me bajtese96.75x60.97x19.1, Garancia min 24 muaj
3	Tharëse rrobash 9 kg	Cope	Tharëse pompe nxehtesie min 9 kg , min A+,258kwh,65db,850w, Gjatesia 595mm, lartësia8 49mm,thellessia 649 mm, garancia 24 muaj
4	Lavatriçe 10 kg	cope	Kapaciteti min 10kg, Klasi i energjise min A+,Centrifuge me efikasitet te larte 1400rpm,kosh i gjere dhe i madh 10 kg, garancia min 24 muaj
5	Lavatriçe 18 kg	cope	Programet min 10, Ekrani digjital Po Permasat H 98.4xP 68.6x D 89.8 cm, Kapaciteti I ngarkeses 18 Kg ,Shpejtesia e Centrifugimit e lartw, Bllokimi per femije Po ,Vonesa kohore Po,Vleresimi I energjise C,lloji I daulles SWIRL,Niveli I zhurmes 72dB,Konsumi Vjetor i energjise 76kwh per 100 cikle
6	Frigorifer 500lt	cope	Vellimi i pergjithshem bruto min 500 lt, Ftohje/shkrirje , ventilator i dyfishte ftohes, kapaciteti ngrires min 145 lt, teknologjia e ngirjes e shpejte, mbyllje anti-bakterjale,bllokim prinderor,njoftim i deres se hapur, niveli i zhurmes 38dbA, konsumi i energjise 195 Kwh/vit , konsum min A+, permasat 192x70x75, gama e lartesisë 181-200cm, lloji i ftohjes FullNo frost, garancia 24 muaj
7	Sobë gatimi me gaz dhe korent	cope	Tavoline pune me linja te rrumbullakosura, Kapak xhami I tymosur,5 ndezes me unaze qendrore, Ndezje automatike me buton shtypes te forta me rozete, Kohematesi mekanik i minutave me sinjal akustik,Furre elektrike shumefunksionale me min 8 programe gatimi, Dera e fures me 3 gota te brendshme dhe zgaver te emaluar ,Pastrohet lehte shishe me gaz te lengshem ,Permasat WxDxH 90x60x85-90,

8	Frigorifer banak ngrirës	cope	*Tipi I vendosjes: Qendrim I lire, Ngjyra/Materiali: Metalik, Lloji i ftohjes: MinFrost, Kapaciteti total: min 310 l, Paneli i kontrollit: Mekanik, Opsione Ekstra: MultiZone, Klasi i energjise: min A+, Mbrojtja e ushqimeve: MinFrost, Kapaciteti NETO (Ngriresi/Freskuesi): 300, Kompresori: ProSmart Inventer, Niveli i zhurmës (dBa): 42, Permasat (Gj x L x Th) (cm): 110 x 85 x 70
9	Frigorifer kollon	cope	* Frigorifer freskues kollone, Kapaciteti neto: min 300L, Ndriçim i brendshëm LED, Përmasat: min 185x70x50 cm, Shpenzimet e energjisë: 227 kWh /vit, Niveli i zhurmës: 35 dB
10	Fshesë me korent	cope	Tipi: Fshese me korent, Kapaciteti: 1.5 lt, Peshë 4.5 kg, Lloji I depozitimit te pluhurit gote, Tipi I filtrit Allergy H13Filter, Funksion larje, Garancia 24muaj
11	Bolier uji	cope	Lloji : Horizontal, Kategoria : Bolier, Permasat ne cm: 79x44x46, Kapaciteti ne litra :80, Material i brendshem: Enamel, Sistem stakues : Po
12	Kondicioner 9000 BTU	cope	siperfaqja e mbulimit 25m2, Sistem WIFE ,Fuqia 9000BTU, Klas energjie min A++, lloji I gazit R32, Niveli i zhurmës 19dB, permasat 19x70.8x26.3 cm, Teknologjia Inverter, garancia 24 muaj
13	Kondicioner 12 000 BTU	cope	siperfaqja e mbulimit 24-28m2, Sistem WIFE, Fuqia 12000BTU, Klas energjie min A++, lloji I gazit R32, Niveli i zhurmës 54dB/61DB, permasat 27x75x21 cm, Teknologjia Inverter, garancia 24 muaj
14	Aspirator me shinë	cope	Kapaciteti 336, masa 60x18x12cm, Ndricimi 2x28W, Tensioni 220-240V, fuqia 206W, garancia 24 muaj
15	Furrë inkaso	cope	Lloji: Furre + Suprine, Kapaciteti min 70 L, Paneli I kontrollit mekanik ,Ekran LCD Led, Vetpastrim Po, Menyra e hapjes normale, Klasi I enrgjise min A+, Garancia 60 muaj, menyra e pjekjes Elektornike min 6 funksione
16	Pianurë	cope	Nr I zonave te gatimit 4, Tipi Induksion, Paneli I kontrillit me prekje, garancia 24 muaj

Shënim: Për çdo certifikatë, standard, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga autoriteti kontraktor përfitues për objektin që prokurohet sipas nevojës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, bazuar në nevojat e autoritetit kontraktor përfitues.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT